



| | | | |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Prijmljeno / Prodato Received / Delivery | 01.08.2022 | 2 | viti god year |
| Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKPMSTICK | 4457/2022 | | 114 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.541/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga; Eshref Shabani kryetar, Malsore Gashi - Bajraktari, dhe Jeton Koca, anëtar, si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr.541/2022 të datës 17.06.2022, së ankueses me adrese banimi: nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Ekonomisë, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47, 48 paragrafi 1 dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.07.2022, mori këtë.

V E N D I M

Përfundon Procedimi Administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.541/2022 e datës 17.06.2022 të parashtruar nga ankuesja

Arsyetim

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, nga shkresat e lëndës ka konstatuar se Ministria e Ekonomisë me datë 19.04.2022 ka shpallur konkursin për pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm (RN00008364)" në të cilin ka aplikuar edhe ankuesja.

Ankuesja e pakënaqur me zhvillimin e procedurave të rekrutimit pasi që të njëjtës i është refuzuar aplikacioni ka parashtruar ankesë brenda institucionit, ndërsa Udhëheqja e Divizionit për Burime Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë, ka nxjerr vendim me datë 27.05.2022 përmes të cilit e ka refuzuar ankesën e ankueses.

Ankuesja, kundër vendim të datës 27.05.2022 të Udhëheqëses së Divizionit për Burime Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë dhe njoftimit numër:1122 të datës 18.05.2022 për përfshirjen e kandidatëve të cilët kanë kaluar fazën e verifikimit paraprak, me datë 17.06.2022 ka parashtruar ankesë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar me numër protokoll 3561/2022, me pretendimet ankimore se Njësia e pranimit me rastin e verifikimit paraprak të aplikacionit ka zbatuar gabimisht dispozitat e ligjit dhe ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 27.06.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankese të Ministria e Ekonomisë. Ndërsa me datë 01.07.2022, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 541/2022, e datës 17.06.2022, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursi i datës 11.02.2022; Diplomë me numër 2692, e datës 18.03.1999; Licence e datës 05.09.2011; Certifikatë e datës 28.09.2011; certifikatë e datës 29-31; certifikatë e datës 29-30, shtator e vitit 2014 Ankesë e datës 23.05.2022, me numër protokoll 1178, drejtuar Udhëheqëse së Njesisë së Burimeve Njerëzore; Njoftimi i datës 18.05.2022; Njoftimi i darës Vendimi nr. 1247, e datës 27.05.2022, i Udhëheqës së Divizionit të Burimeve Njerëzorë të Ministrisë së Ekonomisë. Njoftimi me numër protokoll 1441, e datës 22.06.2022; Vendimi i datës 22.06.2022; Vendimi i datës 30.05.2022, me numër protokoll 1256, për Themelimin e komisionit për vlerësim; Akt Emërimi i datës 24.08.2011; Diplomë e datës 18.03.1999; Licencë me numër 014/2015; Licencë me numër 122/2011; Certifikatë e datës 08.11.2018; Certifikatë e datës 28.09.2011; Certifikatë e datës 29-31; Certifikatë e datës 04-05, e muajit mars të vitit 2015; Certifikatë e datës 29-30, e vitit 2014; e-maili i datës 23.05.2022; Vendimi i datës 18.05.2022, me numër protokoll 1121, e Udhëheqëses së Divizionit për Burime Njerëzore; Kërkesa për punësim e me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 18.03.1999, me numër protokoll 2692; Ndryshimi dhe plotësimi i akt Emërimit të datës 04.09.2012; Kontrata e punës e datës 21.03.2011; Vendimi i datës 11.12.2019; Vendimi i datës 12.07.2019; Vendimi i datës 18.04.2019; Vendimi i datës 07.11.2017; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021, për Vendim i datës 14.04.2021; Licenca e datës 01.07.2015; Licenca e datës 05.09.2011; Vendimi i datës 18.05.2022, me numër protokoll 1118, i Udhëheqëses së Divizionit për Burime Njerëzore; Kërkesa për punësim e me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 29.03.2007, me numër 2524; certifikatë e datës 27-28, e muajit janar të vitit 2009; certifikatë e datës 06-07, e muajit janar të vitit 2006; certifikatë e datës 17-21, e muajit janar të vitit 2008; certifikatë e datës 20, tetor të vitit 2016; certifikatë e datës 19-20, e muajit janar të vitit 2016; certifikatë e datës 01-11, e muajit mars të vitit 2014; certifikatë e datës 26-27, e muajit mars të vitit 2016; Formuari për Vlerësimin e rezultuarve të Punës, për Vendimi i datës 24.05.2018; Vërtetim i datës 12.05.2022, me numër protokoll 3481; Vërtetim i datës 12.05.2022; Vendim i datës 24.05.2022; Certifikatë e datës 17-20, e muajit mars të vitit 2017; Certifikatë e datës 15-18, e vitit 2009; Certifikatë e datës 26-27, e muajit maj të vitit 2016; Certifikatë e datës 10-12 e muajit dhjetor të vitit 2015; Certifikatë e datës 01-11, e muajit mars të vitit 2014; Certifikatë e datës 14, e nëntor të vitit 2008; Certifikatë e datës 27-28, e muajit mars të vitit 2008; Certifikatë e datës 06-07, e muajit nëntor të vitit 2006; Certifikatë e datës 19-20, e muajit maj të vitit 2016; Akt

Emërimin e datës 01.01.2011; Kërkesa për punësim e me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 16.01.2020, me numër 2273; Diplomë e datës 28.04.2004, me numër protokoll 898; Certifikatë e datës 15-16, e muajit dhjetor të vitit 2016; Certifikatë e datës 20-21, e muajit prill të vitit 2015; Certifikatë e datës 26,27, prill 5,6,7,11,12, e muajit maj të vitit 2021; Vërtetim i datës 09.07.2002; Vërtetim i datës 18.10.2013; Vërtetim i datës 10.05.2016; Formuari për vlerësimin e rezultateve në punë për dëshmi për masën disiplinore; Akt Emërimi i datës 07.12.2011; Diplomë e datës 16.01.2020; Vendim i datës 12.11.2012; Vendim i datës 21.04.2020; Vendim i datës 10.07.2020; Vërtetim i datës 10.05.2016; Vendim i datës 21.04.2020; Kërkesa për punësim e me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 22.10.2008; Diplomë e datës 22.10.2008, me numër 663; Diplomë e datës 20.03.2015, me numër 657; Vërtetim i datës 25.03.2021; Certifikatë e datës 12-13, e muajit mars të vitit 2014; Akt Emërimi i datës 01.02.2012; Ndryshmi dhe plotësim i Akt Emërimin të datës 25.02.2016; Certifikatë 2018-2020; Certifikatë e vitit 2020; Certifikatë e vitit 2019; Vërtetim i datës 26.07.2021; Vërtetim i datës 27.08.2018; Ndryshimi dhe plotësimi i Akt Emërimin të datës 25.02.2016; Kontratë e punës e datës 01.09.2004; Formuari për vlerësimin e rezultateve në punë për Vërtetim i datës 10.01.2022; Kontratë e punës 21.07.2019; Kontrata për marrëveshje shërbime të veçante, e datës 18.10.2018; Kontrata për marrëveshje shërbime të veçante, e datës 24.07.2017; Vërtetim i datës 27.08.2018; Diplomë e datës 25-09.2003, me numër protokoll 333; Diplomë e datës 20.03.2015 me numër protokoll 657; Kërkesa për punësim e me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 26.04.1991, me numër protokoll 210; Diplomë e datës 30.03.2013; Vërtetim i datës 06.03.2018; Licencë e datës 21.04.2016; Formuari për vlerësimin e rezultateve në punë për Kërkesa për punësim e me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 16.01.2012, me numër protokoll 2927; Certifikatë e datës 10.11.2017; Vërtetimi i datës 09.11.2018; Akt Emërimi i datës 18.05.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë, për Veremiti i datës 11.05.2021; Kërkesa për punësim e me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 03.10.2010, me numër protokoll 20; Diplomë e datës 04.10.2007, me numër protokoll 326; Certifikatë e datës 12-13, muajit mars të vitit 2014; Certifikatë e datës 03.09.2009; Certifikatë 2015-2017; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 31.12.2011; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 02.08.2010; ; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë, për Certifikatë e datës 25.08.2017; Përgjigje në ankesë e datës 01.07.2022, me numër protokoll 3866/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuses, është bërë i pamundur, *sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Ekonomisë me datën 22.06.2022 ka nxjerr vendimin me nr.1448 me të cilin ka anuluar procedurën e rekrutimit për pozitën: "Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm (RN00008364)" ngritje në detyrë i publikuar me datë 19.04.2022, konkurs i cili në këtë ankesë është objekt shqyrtimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i'u referuar dispozitave të nenit 101 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 dhe nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: „ Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë.”, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e datës

17.06.2022 të ankueses është bërë i pamundur sepse për rastin e procedurës së rekrutimit për pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm (RN00008364)" ngritje në detyrë i publikuar me datë 19.04.2022, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Ekonomisë me datës 22.06.2022 ka nxjerr vendimin me numwr:1448 përmes të cilit e ka anuluar procedurën e rekrutimit, në të cilin kishte kandiduar edhe ankuesja.

Andaj, bazuar në këto rrethana, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, vendosi që ankesa e parashtruar nga ankuesja të përfundohet procedimi administrativ.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.541/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.